



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 765 Akti

Nr. 807 Vendimi
Tiranë, më 10.10.2024

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Firdes Shuli	Kryesuese
Lulzim Hamitaj	Relator
Etleda Çiftja	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Jonida Vrana, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi, në datën 10.10.2024, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Jurgen Selimi**, me detyrë ndihmës ligjor në Gjykatën Administrative të Apelit.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, subjektin e rivlerësimit, vëzhguesin ndërkombëtar, si dhe pasi shqyrtoi dhe diskutoi mbi tërësinë e çështjes që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Jurgen Selimi, me detyrë ndihmës ligjor në Gjykatën Administrative të Apelit, i cili në seancën dëgjimore publike të datës 10.10.2024 kërkoi konfirmimin në detyrë,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Jurgen Selimi gjatë periudhës së fillimit të procesit të hetimit administrativ ka ushtruar detyrën e ndihmësit ligjor në Gjykatën Administrative të Apelit. Për shkak të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ky subjekt i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
2. Z. Jurgen Selimi u është nënshtruar procedurave të rivlerësimit, duke u shortuar si subjekt në shortin e hedhur në datën 15.6.2021 nga Komisioni, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, me trup gjykues të përbërë nga komisionerët Lulzim Hamitaj, Firdes Shuli dhe Etleda Çiftja.
3. Gjatë hetimit administrativ është njoftuar subjekti i rivlerësimit mbi përbërjen e trupit gjykues, duke i kërkuar gjithashtu të shprehej lidhur me ekzistencën e konfliktit të interesit me anëtarët. Subjekti ka konfirmuar me anë të postës elektronike të datës 16.7.2021 mospasjen e ndonjë konflikti interesi me anëtarët e trupit gjykues që i ishin bërë me dije.
4. Në vijim, pasi të gjithë anëtarët deklaruan mospasjen e konfliktit të interesit, me vendimin nr. 1, datë 18.6.2021, trupi gjykues vendosi të fillojë një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, si dhe të caktojë kryesuese të trupit gjykues komisioneren Firdes Shuli. Relatori i çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në nenin 14, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
5. Në zbatim të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, subjekti i rivlerësimit ka nisur procedurat e rivlerësimit, si vijon:
 - a) plotësimi dhe dërgimi i deklaratës së pasurisë sipas shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016 pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI) brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 31;
 - b) plotësimi dhe dërgimi i deklaratës për kontrollin e figurës sipas shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016 pranë Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim AKSIK, ish-DSIK), brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 35;
 - c) plotësimi dhe dërgimi i formularit të vetëvlerësimit profesional sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016 pranë organit të vlerësimit të aftësive profesionale brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 41.
6. Me vendimin nr. 2, datë 25.9.2024, Komisioni vendosi të mbyllë hetimet dhe, në bazë të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, vlerësoi që procesi i rivlerësimit për këtë subjekt të bazohej në të tria kriteret e rivlerësimit të parashikuara nga ligji nr. 84/2016.
7. Në datën 27.9.2024, Komisioni e njoftoi subjektin e rivlerësimit nëpërmjet postës elektronike mbi rezultatet e hetimit kryesisht dhe e ftoi atë për t’u njohur me dosjen dhe provat e administruara (nëse e vlerësonte të nevojshme), në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35-40 e 45-47 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe për të paraqitur shpjegimet e kërkuara në fund të hetimit administrativ, duke i dhënë kohë deri më 4.10.2024. Subjekti paraqiti shpjegimet e veta brenda afatit të caktuar nga Komisioni.
8. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi shpjegimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit nëpërmjet vendimit nr. 3, datë 8.10.2024, vendosi caktimin e seancës dëgjimore në datën 10.10.2024, duke e njoftuar subjektin përmes postës elektronike për këtë vendimarrje.

II. SEANCA DËGJIMORE

9. Seanca dëgjimore u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 10.10.2024, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi.
10. Në vijim, pasi dëgjoi relacionin, subjekti Jurgen Selimi, i paraqitur me përfaqësuesin ligjor, parashtruan shpjegimet përkatëse lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke iu referuar edhe shpjegimeve të paraqitura më herët me shkrim. Në fund të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë. Seanca dëgjimore u mbyll, për të rifilluar po në datën 10.10.2024 për shpalljen e vendimit.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

11. Subjekti i rivlerësimit ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit, duke u përgjigjur në kohë kur i është kërkuar – sipas parashikimeve të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 – përgjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ.

IV. HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI

12. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu një hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (i) provat e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI, në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (iii) raportin mbi kontrollin e figurës së dorëzuar në Komision nga AKSIK-ja; (iv) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (v) raportin e përpiluar nga KLGJ-ja; (vi) deklaratimet dhe përgjigjet e subjektit të rivlerësimit të bëra me anë të komunikimit elektronik; (vii) shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit pas njoftimeve të mbylljes së hetimeve administrative; (viii) argumentimet e paraqitura në seancë dëgjimore; (ix) faktet e njohura botërisht.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

13. Bazuar në nenet 30-33 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja ka dërguar në Komision raportin lidhur me deklaratimet dhe vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, duke konstatuar se:
 - *deklarimi nuk është i saktë dhe në përputhje me ligjin;*
 - *ka burime të ligjshme financiare për të justifikuar pasuritë;*
 - *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
 - *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
 - *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*
14. Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur mbi çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse mbi të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.
15. Hetimi administrativ në lidhje me vlerësimin e pasurisë ka konsistuar në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose përdorim; (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaratimeve të rreme apo të ndonjë konfliktit të interesave, të parashikuara nga pika 5 e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

1. Automjet tip “Ford Focus”, blerë në vitin 2016, në vlerën 3.200 euro

16. Subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* se ka në pronësi pasurinë e llojit automjet, në masën 50% me bashkëshorten. Kjo pasuri është përfituar nëpërmjet kontratës nr. ***, datë 15.6.2016, në shumën 3.200 euro, nga shtetasi E. J.¹. Si burim për krijimin e kësaj pasurie subjekti ka deklaruar kursimet nga paga ndër vite.
17. Gjykata Administrative e Apelit Tiranë ka bërë me dije se nuk kanë rezultuar çështje të regjistruara apo të gjykuara me palë shtetasin E. Q. J.
18. Nga shqyrtimi i dosjes së automjetit të përcjellë nga DPSHTRR-ja² ka rezultuar se shtetasi E. J. e kishte blerë automjetin në analizë në datën 9.5.2016 nga shtetasi italian C. M., në vlerën 600 euro. Referuar deklaratës doganore të datës 12.5.2016, është paguar detyrimi doganor në vlerën 20.880 lekë. Subjekti nuk rezulton të ketë lëvizur jashtë territorit të Shqipërisë me automjetin e deklaruar në pronësi të tij, por është konstatuar një udhëtim i datës 11.9.2013 dhe një tjetër i datës 23.9.2014, të kryera me automjetin me targë *** nga pika kufitare Morinë. Ndërsa, për personat e lidhur me të nuk rezultojnë udhëtime. Në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ai dhe anëtarët e familjes nuk kanë udhëtuar jashtë Shqipërisë.
19. Nga të dhënat e sistemit TIMS të përcjella nga DPPSH-ja³, subjekti nuk rezulton të ketë lëvizur jashtë territorit të Shqipërisë me automjetin e deklaruar në pronësi të tij, por është konstatuar një udhëtim i datës 11.9.2013 dhe një tjetër i datës 23.9.2014 me automjetin me targë *** nga pika kufitare Morinë, ndërsa për personat e lidhur me të nuk rezultojnë udhëtime.
20. Nga verifikimi i kryer nga Komisioni në sistemin *online* të AMF-së, është konstatuar se automjeti i mësipërm, në periudhën kur është kryer udhëtimi, ka qenë në pronësi të shoqërisë përmbarimore “****”, në të cilën subjekti ka qenë i punësuar për periudhën shtator 2012 – tetor 2014.
21. Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti ka deklaruar se udhëtimi i datës 11.9.2013, së bashku me kolegun Sh. Sh., me automjetin tip “Dacia”, me targë ***, të siguruar nga punëdhënësi, është kryer me qëllim pjesëmarrjen në një proces gjyqësor të zhvilluar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës. Shpenzimet janë mbuluar nga punëdhënësi, ndërsa ushqimi në vlerën rreth 10-20 euro është mbuluar nga subjekti, pasi shpenzimet rimburoheshin në formë dietash nga punëdhënësi në një masë të caktuar. Subjekti u ka bashkëlidhur përgjigjeve të tij një korrespondencë të brendshme me stafin e shoqërisë në formë elektronike në lidhje me çështjen gjyqësore të përfaqësuar, si dhe ka sqaruar se ka një gabim material tek data e raportit. Referuar datës dhe orës së dërgimit të *email*-it, vërehet se bëhet fjalë për veprimtarinë e punës së zhvilluar një ditë më parë.
22. Ndërsa lidhur me udhëtimin njëditor të datës 23.9.2013, në rrethin e Tropojës, subjekti ka parashtruar se ka qenë një udhëtim për arsye personale dhe është shfrytëzuar rasti, pasi ish-kolegu ishte i ngarkuar me punë në këtë rreth dhe ka shkuar me mjetin e tij, pasi nuk dispononte mjet transporti personal. Subjekti ka shpjeguar se për këtë udhëtim ka shpenzuar përafërsisht 3.000 - 4.000 lekë.

1.1 Analiza financiare për krijimin e pasurisë automjet

23. Subjekti ka deklaruar se si burim krijimi për pasurinë automjet, në shumën 3.200 euro, kanë shërbyer të ardhurat e tij nga paga ndër vite.

¹ Sipas certifikatës së pronësisë datë 16.6.2016, automjeti me targë *** ka rezultuar në emër të z. Jurgen Selimi.

² Shkresa nr. *** prot., datë 31.1.2024.

³ Shkresa nr. *** prot., datë 31.1.2024.

24. Komisioni ka kryer analizën financiare të të ardhurave⁴ dhe shpenzimeve të subjektit dhe familjarëve të tij (sipas certifikatës familjare). Referuar dokumentacionit të administruar lidhur me të ardhurat e subjektit, ka rezultuar se subjekti ka qenë i punësuar: (i) pranë shoqërisë “****” (për periudhën janar 2012 – mars 2012); (ii) pranë shërbimit përmbartimor “****” (shtator 2012 – tetor 2014); (iii) pranë shoqërisë “****” (nëntor 2014 – mars 2016); (iv) si këshilltar ligjor në Gjykatën Administrative të Apelit (të ardhura nga paga nga muaji prill 2016 e në vijim), si dhe të ardhurat e bashkëshortes së tij, znj. A. S., nga punësimi pranë: (a) Drejtorisë Arsimore të Qarkut (janar 2012 – maj 2019); (ii) Drejtorisë Arsimore Qytet (qershor 2019 – dhjetor 2023), si dhe pagesa për vlerësimin e testeve sipas kreditimeve në llogarinë e saj bankare.
25. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti bashkëlidhur deklaratës *Vetting*, konkretisht vërtetimi datë 19.10.2016, i lëshuar nga shoqëria “****”, citohet se për periudhën nëntor 2014 – prill 2016 z. Jurgen Selimi ka përfituar paga, shpërblime dhe dieta në shumën 1.892.677 lekë.
26. Komisioni ka verifikuar llogaritë bankare të subjektit dhe ka konstatuar se referuar *statement of account* të llogarisë rrjedhëse të pagës nr. *** pranë BKT-së në emër të tij, në datën 13.6.2016, gjendja e llogarisë ka qenë në vlerën 479.952,20 lekë. Po në këtë datë, në llogarinë e sipërcituar, subjekti ka kryer një tërheqje në shumën 470.000 lekë. Komisioni ka verifikuar llogarinë në fjalë dhe ka konstatuar se për periudhën janar – qershor të vitit 2016 subjekti ka përfituar të ardhura nga paga në shumën 199.035 lekë, si dhe dieta në shumën 419.280 lekë.
27. Komisioni e ka ftuar subjektin të sqaronte shkaku e përfitimit nëpërmjet bankës të shumave me përshkrimin “dieta”, si dhe qëllimin për të cilin ishin përfituar ato, nisur edhe nga fakti se vlera e tyre tejkalonte shumën e të ardhurave të tij nga paga. Në përgjigje të këtij pyetësi, subjekti ka deklaruar se për shkak të distancave dhe kohës së gjatë në funksion të përmbushjes së detyrave, faktit se shpeshherë është detyruar të qëndrojë në hotele, si dhe performancës së tij në përmbushjen dhe realizimin e objektivave, nga ana e punëdhënësit në vijimësi i janë akorduar dieta mujore, të cilat shpeshherë mund të kenë qenë në një masë më të lartë edhe se vetë paga. Kjo pasi për pjesën më të madhe të muajit, dhe në disa raste për të gjithë muajin, detyra është ushtruar në rrethe, jashtë Tirane, ku punëdhënësi kishte qendrën e punës.
28. Po në këtë pyetësor, i pyetur lidhur me burimin e të ardhurave (kursimeve) të përdorura për blerjen e automjetit, subjekti ka parashtruar se në datën 13.6.2016 ka tërhequr nga llogaria vlerën prej 470.000 lekësh dhe ka kryer këmbimin në monedhën euro në masën 3.200 euro, likuiduar *cash* në momentin e përpilimit të kontratës nr. ***, datë 15.6.2016, pranë noterit E. K. Në përmbajtje të kësaj kontrate, shitësi E. J. ka konfirmuar faktin e marrjes së shumës 3.200 euro. Po ashtu, subjekti ka parashtruar se në momentin e dorëzimit të deklaratës *Vetting*, në datën 25.1.2017, pranë ILDKPKI-së, nuk dispononte gjendje *cash* as ai dhe as personi i lidhur me të, A. S.
29. Duke qenë se subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 4, ku, veç shpjegimit të shkaqeve të përfitimit të dietave nga punëdhënësi, ka cituar edhe deklarin e datës 19.10.2016, bërë nga ish-punëdhënësi – administratori i shoqërisë “****” sh.p.k. – sipas të cilit “*Jurgen Xh. Selimi për periudhën e punësuar pranë shoqërisë sonë ka përfituar në llogarinë e tij nga paga shpërblime, dieta, një shumë prej 1.892.677 lekësh*”, si dhe faktit se subjekti: (i) referon edhe pagesa (përtej pagës) si shpërblime për performancën dhe realizimin e objektivave, sikurse për rastet e punës me orare të zgjatura (jashtë rrethit); (ii) ish-punëdhënësi referon pagesa për subjektin, veç pagave, duke cituar përfitime në formën e dietave (të cilat prezumohen si një rimbursim i shpenzimeve realisht të kryera nga subjekti) dhe shpërblime (të cilat mund të

⁴ Shkresa nr. *** prot., datë 1.2.2024, nga ISSH-ja, që vërteton të ardhurat e subjektit Jurgen Selimi për periudhën janar 2012 – 15.6.2016, si dhe të ardhurat e bashkëshortes A. S. për periudhën janar 2012 – 15.6.2016.

konsiderohen si të ardhura shtesë) – mbetet i paqartë për Komisionin raporti përkatës i këtyre shumave.

30. Në këto kushte, Komisioni e ka ftuar subjektin nëpërmjet pyetësorit nr. 5 të saktësonte masën monetare të përfituar si shpërblim (për performancë dhe vështirësi apo orë jashtë orarit) në raport me pjesën e përfituar si rimbursime të thjeshta për shpenzimet e kryera prej tij, në funksion të detyrave dhe shërbimeve brenda marrëdhënies së punës, duke paraqitur edhe dokumentacionin ligjor përkatës.
31. Në përgjigje të këtij pyetësori, subjekti ka deklaruar se sqarimet e mëparshme kanë konsistuar vetëm në shpjegimin sipas kërkesës mbi zërin e shumave të përfituara si dieta dhe jo për komponent tjetër të pagës, duke u munduar të pasqyronte sa më saktë përmbajtjen e këtij zëri dhe qëllimin për të cilin ajo është akorduar dhe jo referimin në pagesa (përtej pagës) si shpërblime ose shtesa mbi pagën. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se për gjithë kohëzgjatjen e punësimit të tij paga është kredituar në mënyrë të rregullt në llogarinë pranë BKT-së dhe si akt të vetëm shkresor provues disponon *statement of account* të llogarisë rrjedhëse të pagës nr. ***, nga ku rezulton të jenë kredituar shuma vetëm me përshkrimin “dieta” dhe si pasojë nuk disponon informacion mbi përlllogaritjen analitike të pagës, duke specifikuar kreditimin sipas zërit përkatës. Me qëllim saktësimin e përlllogaritjes së këtyre vlerave të përfituara, subjekti u është drejtuar shoqërive përmbartimore “****” sh.p.k. dhe “****” sh.p.k. me shkresën datë 12.9.2024 “Kërkesë për informacion”. Subjekti ka bashkëlidhur dëftesën postare të datës 12.9.2024.
32. Gjatë hetimit, AK Invest⁵ ka bërë me dije se z. Jurgen Selimi ka kryer tërheqje dhe dërgesa jashtë Shqipërisë nga Italia, duke mos specifikuar vlerat dhe datat e këtyre transaksioneve. Në vijim, në përgjigje të kërkesës së Komisionit⁶, MoneyGram International⁷ ka bërë me dije se dispononte informacion vetëm për periudhën 24.1.2019 – 20.3.2024, gjatë së cilës z. Selimi nuk rezultonte të kishte kryer ndonjë transaksion.
33. Po ashtu, Komisioni ka pyetur subjektin nëpërmjet pyetësorit nr. 2, i cili ka deklaruar se nuk ka kryer asnjëherë transaksione nëpërmjet MoneyGram, si dhe ka paraqitur vërtetimin nr. *** prot., datë 17.5.2024⁸, nga AK Invest sh.a. institucion financiar - partner i MoneyGram International për Shqipërinë, ku vërtetohet se z. Jurgen Selimi, i datëlindjes 15.7.1983, me numër personal identifikimi ***, nuk ka kryer transferta monetare nëpërmjet rrjetit AK Invest sh.a.
34. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë hetimit, ka rezultuar se përgjatë periudhës janar – qershor 2016, kur është tërhequr shuma 470.000 lekë, nuk është kryer ndonjë investim nga subjekti në pasuri të luajtshme apo të paluajtshme, veç automjetit në analizë.
35. Përveç sa më sipër, Komisioni ka konstatuar se subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën *Vetting* llogarinë rrjedhëse në BKT në emër të tij, në shumën 157,48 lekë, dhe një llogari në emër të bashkëshortes po në këtë bankë, në shumën 83.708 lekë, në datën 31.12.2016. Gjithashtu, subjekti nuk ka deklaruar në këtë deklaratë të ardhura nga shpërblimet apo dietat.
36. Në përfundim të sa më sipër, Komisioni ka kryer analizën financiare, me qëllim verifikimin e disponibilitetit financiar të subjektit për krijimin e pasurisë së llojit automjet, në vlerën 3.200 euro. Në këtë analizë janë përfshirë të ardhurat nga paga e subjektit për periudhën janar – qershor 2016, në shumën 199.035 lekë, si dhe të ardhurat e bashkëshortes për të njëjtën periudhë, në shumën 281.641 lekë. Po ashtu janë përlllogaritur shpenzimet e jetesës për të

⁵ Shkresa nr. *** prot., datë 1.2.2024, nga AK Invest.

⁶ Shkresa nr. *** prot., datë 19.3.2024, nga Komisioni drejtuar MoneyGram International.

⁷ Shkresa nr. *** prot., datë 21.3.2024, nga MoneyGram International.

⁸ Vërtetimi nr. *** prot, datë 17.5.2024, nga AK Invest.

njëjtën periudhë, në shumën 431.002 lekë, si dhe shpenzimet për qiranë në shumën 120.000 lekë.

37. Nga llogaria bankare e subjektit në BKT, është konstatuar se për periudhën në analizë subjekti ka përfituar përpos pagës edhe dieta në shumën 419.280 lekë. Ndonëse subjekti ka depozituar një vërtetim nga punëdhënësi (citurar më sipër), si dhe ka shpjeguar se bëhet fjalë jo vetëm për dieta, por edhe shpërblime për performancën, deri në këtë fazë të hetimit, Komisioni, në referencë të orientimit të Kolegjit⁹, ku ndër të tjera citohet se “*Trupi gjykues vlerëson se të ardhurat e deklaruara nga subjekti si të përfituara në formën e dietës janë vlera monetare të destinuara për të mbuluar shpenzimet e kryera nga zyrtarët gjatë veprimtarisë së tyre, në funksion të përmbushjes së detyrës dhe, për rrjedhojë, ato nuk mund të konsiderohen si të ardhura me burim marrëdhënien e punës, sipas nenit 4 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar*”, ka vlerësuar të mos i përfshijë këto të ardhura në analizën financiare, për sa kohë subjekti nuk paraqiti ndonjë dokumentacion/provë në mënyrë që të identifikonte masën e të ardhurave të përfituara si “dieta” dhe ato të përfituara si “shpërblime”, për një kualifikim dhe kategorizim të saktë të trajtimit të të ardhurave në fjalë.
38. Në përfundim të sa më sipër, nga analiza e kryer, subjekti ka rezultuar me mungesë të burimeve të ligjshme financiare për krijimin e pasurisë së llojit automjet, sikurse është përshkruar në tabelën vijuese.

Analiza financiare për blerjen e automjetit 1.1.2016 – 15.6.2016

Të ardhura nga paga e subjektit	199,035
Të ardhura nga paga e bashkëshortes së subjektit	281,641
Totali i të ardhurave	480,676
Shpenzime jetese	431,002
Shpenzime qiraje	120,000
Blerje automjeti	441,120
Shtesë/pakësim i llogarive bankare	44.950
Totali i shpenzimeve	833,063
Rezultati në datën 15.6.2016	(556.426)

39. Në raport me rezultatin e mësipërm, pra me mungesën e burimeve të ligjshme për blerjen e pasurisë automjet, në masën -556.426 lekë, subjektit i ka kaluar barra e provës për të paraqitur prova dhe shpjegime të tjera, për të provuar të kundërtën e rezultateve të Komisionit për këtë pasuri në lidhje me pasaktësitë e konstatuara në deklarinimin e llogarive bankare.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

40. Subjekti ka parashtruar sa vijon:
- a. Në përgjigje të pyetësorit nr. 5, subjekti, ndër të tjera, ka deklaruar se përgjigjja nr. 1 e pyetësorit nr. 4 ka konsistuar vetëm në shpjegimin, sipas kërkesës së Komisionit, mbi zërin “Dieta” të të ardhurave të përfituara dhe për asnjë komponent tjetër të të ardhurave. Subjekti, për të qenë sa më shterues, ka saktësuar qartësisht përmbajtjen e zërit “Dieta” dhe qëllimin për të cilin është akorduar nga punëdhënësi dhe jo referimin në pagesa (përtej pagës) si shpërblime ose shtesa mbi pagën. Veç të tjerash, subjekti ka deklaruar se për gjithë kohëzgjatjen e punësimit pranë këtyre dy shoqërive, “****” sh.p.k. dhe “****” sh.p.k., paga i është kredituar në mënyrë të rregullt në llogarinë e tij pranë BKT-së dhe si akt të vetëm shkresor provues disponon *statement of account* të llogarisë rrjedhëse të pagës nr. ***. Sipas përshkrimit të veprimit përkatës, evidentohet se subjekti ka përfituar të ardhura për punën e kryer në zërat “Paga + dieta”.

⁹ Vendimi nr. 7/2019.

- b. Vlen të theksohet se subjekti nuk ka qenë asnjëherë në dijeni të informacionit mbi përlllogaritjen analitike të përfitimit financiar për detyrën që i ishte ngarkuar nga punëdhënësi.
- c. Në këto kushte, subjekti, me qëllim sigurimin e një informacioni më të detajuar, i është drejtuar me shkresë në datën 12.9.2024 “Kërkesë për informacion” shoqërive punëdhënëse, me qëllim “...për të bërë të mundur përcaktimin e saktë të shumave të përfituara si dieta dhe përmbajtjen e këtij zëri, si dhe raportin e masës monetare të përfituar si shpërblim ose shtesë mbi pagë, në raport me pjesën tjetër të përfitimeve.”
- d. Në lidhje me periudhën 1.9.2012 – 1.9.2014, kohë gjatë së cilës subjekti ka qenë i punësuar pranë shoqërisë “***” sh.p.k., aktualisht shoqëri në proces likuidimi sipas të dhënave të ekstraktit të Qendrës Kombëtare të Biznesit, nuk është bërë i mundur komunikimi me administratorin apo stafin financiar të kësaj shoqërie, pavarësisht përpjekjeve të vazhdueshme. Po ashtu, edhe nga ana e shoqërisë “***” sh.p.k. në lidhje me periudhën e punësimit 2.9.2014 – 13.4.2016, megjithëse vërtetohet marrja dijeni e këtij subjekti sipas dëftesës postare në datën 13.9.2024, si dhe komunikimit verbal me administratorin e kësaj shoqërie, në mënyrë të vazhdueshme është refuzuar për të na kthyer një përgjigje në lidhje me informacionin e kërkuar, me argumentin se nuk disponojmë dokumentacion për shkak të kohës së gjatë nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënies së punës.
- e. Sa më lart u shpjegua dhe provohet, nga ana e subjektit të rivlerësimit në mënyrë të vazhdueshme janë bërë të gjitha përpjekjet për sigurimin e këtij informacioni pranë ish-punëdhënësve të tij. Por, për arsye të pavarura, ai ka qenë në pamundësi objektive për të disponuar këtë dokumentacion në lidhje me mënyrën analitike të përlllogaritjes së pagës sipas zërave përkatës, përveç atyre të pasqyruara në *statement of account* datë 10.9.2024, të lëshuar nga Banka Kombëtare Tregtare. Për këtë arsye, kërkojmë nga ana e Komisionit që të merret parasysh dhe të vlerësohet me objektivitet fakti i pamundësisë objektive për të disponuar këtë dokumentacion, pasi vlerësojmë se do të ishte e padrejtë të penalizohet subjekti për shkak të veprimeve/mosveprimeve të ish-punëdhënësit (subjekt privat), duke pasur parasysh problematikat që e karakterizojnë sektorin privat gjatë ushtrimit të veprimtarisë në vijimësi.
- f. Vlerësojmë të theksojmë se të gjitha të ardhurat e përfituara nga subjekti në llogarinë e tij të pagës janë të ardhura të ligjshme që rrjedhin nga një marrëdhënie pune e rregullt në kushtet e ushtrimit të detyrës së ngarkuar nga punëdhënësi, detyrë që kryesisht ushtrohej jashtë rrethit të Tiranës. Për punën e kryer, përfshi këtu edhe shërbimet në distanca të largëta për të cilat ka qenë e pamundur rikthimi në banesë, punëdhënësi ka paguar edhe shpenzimet e dietave, vlera monetare e të cilave në mënyrë të rregullt kreditohej në llogarinë e pagës së subjektit.
- g. Në analizë të *statement of account*, si më lart cituar, rezulton qartësisht se përveç të ardhurave nga marrëdhënia e punës, subjekti nuk ka përfituar asnjëherë të ardhura nga burime të tjera.
- h. Këto të ardhura të përfituara nga subjekti dhe të kredituara nga punëdhënësi në mënyrë periodike në llogarinë e tij bankare, kanë shërbyer në masën më të konsiderueshme për përmbushjen e nevojave familjare dhe pjesa tjetër në një përqindje të vogël për mbulimin e shpenzimeve që subjekti kishte gjatë përmbushjes së detyrës jashtë qendrës së punës. Kushtet e jetesës kanë imponuar nevojën për kursime në masën më të madhe të mundshme, ndoshta edhe nën parashikimet e INSTAT-it në lidhje me shpenzimet jetike, duke qenë se subjekti jetonte me qira dhe i duhej ta paguante çdo muaj atë dhe detyrimet e tjera për energji elektrike, ujë të pijshëm etj.; kishte përgjegjësinë për mirërritjen e dy fëmijëve të mitur, bashkëshorten me profesion mësuese, e cila merrte një pagë nën mesataren e caktuar. Po ashtu, vlerësojmë të theksojmë se të mbulosh një volum të tillë

pune në lëvizje jashtë Tirane në vijimësi, për të siguruar të ardhura mujore prej vetëm një page minimale, nuk do të kishte asnjë kuptim dobiprurës për sa i përket interesit ekonomik për subjektin dhe familjen e tij. Pra, i vetmi interes financiar i ligjshëm ishin të ardhurat nga dietat, të cilat zinin peshën kryesore të pagesës, duke pasur parasysh natyrën e punës që vetë punëdhënësi kishte caktuar.

- i. Për sa më sipër është arsyetuar, provohet nëpërmjet *statement of account* të llogarisë bankare nr. *** të lëshuar nga Banka Kombëtare Tregtare, shkresa nr. *** prot., datë 24.1.2018, e ILDKPKI-së dhe hetimit administrativ të zhvilluar nga Komisioni, ku rezulton që përveç këtyre të ardhurave të siguruara nga marrëdhënia e punës, subjekti nuk ka përfituar asnjë të ardhur nga burime të tjera.
- j. Nga kursimet e këtyre të ardhurave të punësimit rezulton se në datën 13.6.2016 gjendja në llogarinë bankare ka qenë në vlerën 479.954,20 lekë, e cila ka shërbyer për kryerjen e transaksionit të shitblerjes së automjetit në masën korresponduese me 3.200 euro, veprim juridik i formalizuar me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.6.2016.
- k. Rezulton se Komisioni ka vlerësuar të mos i përfshijë të ardhurat nga dieta në analizën financiare, duke iu referuar edhe praktikës së Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, sipas të cilit është arsyetuar se: *“Trupi gjykues vlerëson se të ardhurat e deklaruara nga subjekti si të përfituara në formën e dietës janë vlera monetare të destinuara për të mbuluar shpenzimet e kryera nga zyrtarët gjatë veprimtarisë së tyre, në funksion të përmbushjes së detyrës dhe, për rrjedhojë, ato nuk mund të konsiderohen si të ardhura me burim marrëdhënien e punës, sipas nenit 4 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar...”*.
- l. Për sa më sipër, vlerësojmë të sjellim në vëmendje të Komisionit se ka një specifikë dalluese midis të ardhurave të përfituara si dieta nga punëmarrësit e organeve publike, të cilat janë trajtuar nga Kolegji i Posaçëm Apelimit, sipërcituar, nga të ardhurat e përfituara si dieta në sektorin privat, pasi nëse për një pjesë të konsiderueshme të organeve publike të ardhurat e përfituara si dieta gjejnë rregullim të posaçëm në aktin nënligjor, VKM-në nr. ***, datë 10.12.2010, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, i ndryshuar, ndryshe ndodh me sektorin privat. Pjesë e këtij sektori ka qenë edhe subjekti i rivlerësimit, për të cilin nuk ekziston një kuadër ligjor rregullues dhe akti nënligjor i sipërcituar përdoret në përgjithësi si orientues, por duke i dhënë gjithmonë përparësi realizimit të qëllimit të politikave të subjekteve private, siç ka ndodhur në rastin konkret objekt hetimi administrativ, ku këto vlera kanë shërbyer edhe për të motivuar punëmarrësit për të marrë përsipër realizimin e detyrës nëpër rrethe, e cila kërkon angazhim më të madh dhe sakrificë, duke qëndruar për kohë të gjatë larg familjes, çka diktonte plotësimin e pritshmërive, duke qenë se kjo përkthehej në të ardhura mujore.
- m. Po ashtu, referuar relacionit datë 27.9.2024 mbi rezultatet e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit Jurgen Selimi, konstatohen pasaktësi në mënyrën e llogaritjes sipas metodologjisë së përdorur nga Komisioni në analizën financiare, duke mos përfshirë të ardhurat si dieta, pasi konstatohet se shpenzimet jetike janë përlllogaritur në bazë të frymëve sipas të dhënave zyrtare nga INSTAT. Pra, sipas analizës financiare të realizuar, duke iu referuar periudhës 2012 – 2016, gjendja familjare përbëhej nga 4 anëtarë dhe, për pasojë, përlllogaritja është kryer në bazë të këtij numri frymësh, ndërkohë rezulton se në analizën financiare nuk janë përfshirë të ardhurat e përfituara nga dietat, duke i konsideruar si shpenzime të kryera nga ana e subjektit në funksion të përmbushjes së detyrës. Këtu vlerësojmë se ekziston një pasaktësi, pasi subjekti nuk mund të ketë kryer dy shpenzime njëkohësisht për të njëjtin qëllim, pra edhe duke përdorur buxhetin familjar, edhe të ardhurat e përfituara nga dieta.

- n. Po ashtu, vlerësojmë se duhej të ishte marrë në konsideratë edhe mosha e dy fëmijëve të mitur, ku J. S. është i datëlindjes 18.7.2011 (periudha 2012 – 2016/1-5 vjeç) dhe J. S. e datëlindjes 31.7.2008 (periudha 2012 – 2016/4-8 vjeç), për pasojë kostoja e jetesës së një të mituri nuk mund të jetë e barabartë me një person madhor.
- o. Gjithashtu, referuar analizës financiare për vitin 2016, konstatohet se ajo është ndarë në dy periudha: 1.1.2016 – 15.4.2016, me një diferencë negative prej -297.487 lekësh dhe periudha 16.4.2016 – 31.12.2016, me bilanc pozitiv prej 83.657 lekësh, ku duket se kjo e fundit nuk është përfshirë në shumën përfundimtare të përllogaritur.
- p. Duke qenë se nga ana jonë është vlerësuar e arsyeshme që në lidhje me rezultatet e analizës financiare nevojiteshin njohuri të posaçme në fushën financiare, nga ana e ekspertit - auditues ligjor me nr. licence ***, NUIS ***, është përgatitur “Raport analiza financiare”, sipas të cilit është arritur në përfundimin se: *“Të ardhurat e familjes së subjektit rrjedhin tërësisht nga burime të ligjshme. Ato janë transparente dhe pasqyruar me vërtetësi në seksionin e të ardhurave. Këto të ardhura mbulojnë në pjesën më të madhe vlerën e pasurisë neto të subjektit si dhe kostot e nevojshme për përbalimin e jetesës (duke u paraqitur me një bilancë negative në shumën -268.797 lekë), në fund të secilës prej periudhave të mbyllura në datën 31 dhjetor 2010 – 2016”*. Bashkëngjitur “Raport analiza financiare” datë 3.10.2024, e përgatitur nga një ekspert - auditues ligjor.
- q. Nisur nga sa më sipër është pasqyruar në konkluzionet e audituesit ligjor në raportin e analizës financiare, kërkojmë nga Komisioni korrigjimin e analizës financiare, duke përfshirë rezultatet e raportit të analizës, si dhe duke rregulluar pasaktësitë sipas aktit të ekspertimit të përgatitur nga eksperti, të depozituar pranë Komisionit bashkë me prapësimet.

Vlerësimi i trupit gjykues

41. Pasi shqyrtoi dhe vlerësoi pretendimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, e në veçanti lidhur me pjesën e të ardhurave të përfituara potencialisht nga subjekti si shpërblim për arritjen e rezultateve, vështirësive apo në sajë të performancës së kontributit profesional të ofruar nga subjekti – ndonëse kanë rezultuar indicie apo prova indirekte të këtij zëri të ardhurash – Komisioni çmon se ky pretendim mbetet i paprovuar në kuptimin e saktësisimit të pjesës takuese, mes shumëve të kaluara në llogarinë bankare të subjektit nga punëdhënësi. Në këto kushte, Komisioni është në pamundësi për të përllogaritur një shumë të caktuar si të ardhur shtesë (përpos atyre të përfshira në analizën financiare). Gjithsesi, parë në këndvështrimin e provës indirekte, si dhe të masës monetare për të cilën bëhet fjalë referuar vetëm segmentit kohor të analizuar në funksion të burimeve financiare të blerjes së automjetit, vërehet se kjo e ardhur (shtesë) nuk rezulton përcaktuese për vendimmarrjen finale të Komisionit mbi procesin e rivlerësimit të këtij subjekti, për sa mbetet e vetme dhe jo penalizuese në aplikim të parimit të objektivitetit dhe proporcionalitetit.
42. Gjithashtu, Komisioni vlerëson se nuk gjenden të bazuara pretendimet e subjektit lidhur me mënyrën dhe vlerën e shumëve të përllogaritura në analizën financiare për familjen e subjektit, pasi ato janë përfshirë e analizuar bazuar në standardet e konsoliduara nga organet ndihmëse, si dhe nga jurisprudenca e Kolegjit, sikurse është cituar edhe në përshkrimet specifike në rezultatet e hetimit administrativ të kryer nga Komisioni. Gjithsesi, edhe në këtë rast vërehet se, nisur nga masa monetare e modifikueshme në analizën financiare *de qua*, nëse do të pranoheshin pretendimet e subjektit, përmirësimi i mundshëm i balancës do të rezultonte pa ndikim konkret në vlerësimin tërësor të këtij rasti.
43. Në këto kushte, duke respektuar standardet e deritanishme mbi metodologjinë për kryerjen e analizës financiare të subjekteve të rivlerësimit, duke u bazuar mbi faktet e provuara nga hetimi kryesisht apo nga vetë subjektet, për rrethanat për të cilat u është kaluar barra e provës,

Komisioni çmon se pamundësia financiare e konstatuar në raport me blerjen e automjetit, në vitin 2016, si më lart, mbetet e pandryshuar.

REZULTATET E ANALIZËS FINANCIARE

44. Në vijim të analizës financiare të kryer mbi deklaratimet periodike ndër vite të subjektit, pas përllogaritjeve të kryera në mënyrë të detajuar sipas viteve, janë paraqitur të gjitha të dhënat mbi të ardhurat, shpenzimet, kursimet, detyrimet dhe nga përllogaritja krahasimore e tyre mund të vlerësohet dhe konkludohet mbi mjaftueshmërinë e burimeve financiare për çdo vit për të përballuar investimet, shpenzimet apo kursimet e deklaruara dhe/ose të konstatuara me të ardhura nga burime të ligjshme, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.
45. Të ardhurat e deklaruara ndër vite dhe ato të dokumentuara, bazuar në përgjigjet e institucioneve dhe dokumentacionit, janë paraqitur nga subjekti bashkëngjitur deklaratës *Vetting* dhe pyetësorëve.
46. Shpenzimet jetike janë përllogaritur në bazë të frymëve sipas të dhënave zyrtare nga INSTAT-i.
47. Shpenzimet e udhëtimit janë përllogaritur duke u bazuar në raportin e hyrje-daljeve sipas sistemit TIMS të subjektit dhe anëtarëve të familjes së tij dhe bazuar në vendimin nr. 11/2019 (JR), datë 22.5.2019, të Kolegjit dhe deklaratimeve të vetë subjektit të në përgjigje të pyetësorëve.
48. Gjendja e likuiditeteve nënkupton gjendjen në fund të çdo viti të ndodhur në të gjitha llogaritë bankare të subjektit dhe anëtarëve të familjes.
49. Kursi i këmbimit i përdorur për shpenzimet/gjendjet bankare në valutë është konsideruar sipas kursit mesatar të fundit të vitit, botuar në faqen zyrtare të Bankës së Shqipërisë.
50. Në këtë analizë janë konsideruar dhe përpunuar të dhënat duke filluar nga viti 2010, vit në të cilin subjekti ka filluar të realizojë të ardhura, siç është detajuar në tabelën vijuese.

Analiza financiare për periudhën prill 2010 - dhjetor 2016

Viti	2010	2011	2012	2013	2014	2015	1.1.2016- 15.4.2016	16.4.2016- 31.12.2016
PASURI	1	23,521	-45,137	42,639	28,102	178,435	168,790	152,157
Autoveture Ford								441,120
Ndryshim likuiditeti	1	23,521	-45,137	42,639	28,102	178,435	168,790	-288,963
TOTAL LIKUIDITETE DEKLARUAR	1	23,521	-45,137	-2,498	25,604	204,039	372,829	83,866
DETYRIME	0	0	0	0	0	0	0	0
PASURI NETO	1	23,521	-45,137	42,639	28,102	178,435	168,790	152,157
Të ARDHURA dokumentuar	743,349	970,684	580,570	791,692	870,661	891,385	264,759	1,022,726
Te ardhura nga paga e subjektit	283,436	476,615	211,746	274,756	281,316	281,316	79,346	590,891
Te ardhura nga paga e b/shortit	459,913	494,069	368,824	516,936	589,345	610,069	185,413	431,835
SHPENZIME	649,860	718,170	804,096	806,872	1,122,988	1,137,104	393,456	786,912
Shpenzime jetese	409,860	478,170	564,096	564,096	879,992	897,104	313,456	626,912
Shpenzime udhetimi				2,776	2,996			
Shpenzime qiraje	240,000	240,000	240,000	240,000	240,000	240,000	80,000	160,000
Shpenzime te tjera								
Analiza dokumentuar	93,488	228,993	-178,389	-57,819	-280,429	-424,154	-297,487	83,657

51. Ndërkohë që nga analiza financiare e kryer nga momenti në të cilin fillon edhe deklarimi i pasurisë nga ana e subjektit të rivlerësimit pranë ILDKPKI-së, prill 2016 – dhjetor 2016, sikurse evidentohet në tabelë, ka rezultuar një bilanc pozitiv në masën 83.657 lekë.
52. Në këto kushte, Komisioni vlerëson se pamundësitë financiare të konstatuara në periudhën përpara detyrës, për sa kohë nuk janë përdorur si burim për krijimin e ndonjë pasurie nga ana e subjektit (apo familjarë të tij), ato nuk mund ta penalizojnë këtë të fundit. Në çdo rast, edhe totali i pamundësisë financiare për të gjithë periudhën e analizuar nuk do të kapërcente pragun

e mungesës së burimeve të tolerueshme, kësisoj edhe në këtë aspekt nuk do të mund të penalizohet ky subjekt.

53. Nga ana tjetër, duke iu referuar pamundësisë për blerjen e automjetit në vitin 2016, në masën (minimale) prej -556.426 lekësh, si dhe bilancit pozitiv, në raport me shpenzimet e tjera të kryera përgjatë detyrës, trupi gjykues çmon se ky subjekt ka mbërritur në nivelin e besueshmërisë në kriterin e pasurisë. Ky konkluzion bazohet në sa më lart dhe në rrethanat indirekte (deklarata e lëshuar nga punëdhënësi në vitin 2016 dhe shumat konkrete të përfituara nga puna e të kaluara në llogarinë bankare të subjektit, si dieta) dhe arrihet nën dritën e parimit të objektivitetit dhe proporcionalitetit.

B. KONTROLLI I FIGURËS

54. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016 është përcjellë pranë Komisionit raporti nr. *** prot., datë 31.10.2017, me të cilin ishte konstatuar përshtatshmëria e subjektit të rivlerësimit Jurgen Selimi.
55. Në vijim të kërkesës së Komisionit për një përditësim e deklasifikim të raportit të tyre, AKSIK-ja me shkresën e datës 4.6.2024 ka përcjellë pranë Komisionit raportin e sipërcituar të deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 28.5.2024, të KDZH-së.
56. Ndonëse Komisioni nuk ka konstatuar elemente që mund të binin ndesh me përfundimet e mbërritura nga AKSIK-ja, është vërejtur se në deklaratën për kontrollin e figurës (shtojca 3), në faqen 3 të saj, dorëzuar në datën 24.1.2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se djali i xhaxhait të tij, shtetasi E. Xh. S., është dënuar dhe vuan aktualisht dënimin sipas nenit 283 të Kodit Penal.
57. Përgjatë hetimit, Komisioni kreu verifikimet lidhur me deklarinimin e mësipërm. Konkretisht, me shkresën nr. *** prot., datë 11.6.2024, Komisioni i kërkoi informacion Ministrisë së Drejtësisë¹⁰ nëse shtetasi E. Xh. S. rezultonte i dënuar. Ministria e Drejtësisë e delegoi kërkesën e Komisionit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve. Kjo e fundit, me shkresën nr. *** prot., datë 27.5.2024, vuri në dispozicion të Komisionit një vërtetim të gjendjes gjyqësore me nr. ***, datë 23.5.2024, në të cilin citohej se: *“1. Shtetasi E. Xh. S., në bazë të vendimit nr. ***, datë 12.11.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është deklaruar fajtor për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” dhe në bazë të nenit 283/1 të Kodit Penal dhe 406 të Kodit të Procedurës Penale është dënuar me 3 vite e 4 muaj burgim. Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal, urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim, duke e vënë në provë për një periudhë kohë prej 3 vitesh, me kusht për të mos kryer vepër tjetër penale. 2. Në bazë të vendimit nr. ***, datë 10.6.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, është deklaruar fajtor për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” në bazë të nenit 283/2 të Kodit Penal, duke u dënuar me 8 vjet burgim. Në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, dënohet me 5 vjet e 4 muaj burgim. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. ***, datë 31.10.2013, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër”.*
58. Pas shqyrtimit të fakteve dhe rrethanave të konstatuara gjatë hetimit, si dhe shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, Komisioni vlerësoi t'i analizojë ato në raport me përcaktimet ligjore përkatëse, si më poshtë vijon.
59. Nisur nga sa më sipër dhe nga verifikimet e vlerësimet e kryera mbi të dhënat e disponuara, është konstatuar se vepra penale e parashikuar në nenin 283/1 dhe 283/2 të Kodit Penal, për të cilat është dënuar shtetasi E. S., përfshihen në gamën e veprave penale të përcaktuara shprehimisht në nenin 3, pikat 8 dhe 15 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilave personi cilësohet si i përfshirë në krimin e organizuar. Duke qenë se shtetasi E. S. bën pjesë në rrethin familjar

¹⁰ Me shkresën nr. *** prot., datë 9.5.2024.

të subjektit, në kuadër edhe të vlerësimit në aspektin etik, Komisioni e ftoi subjektin e rivlerësimit nëpërmjet pyetësorit nr. 3 të paraqiste shpjegime bindëse dhe shteruese lidhur me marrëdhëniet dhe frekuentimet e tij me këtë shtetas. Në përgjigje të këtij pyetësori, subjekti ka shpjeguar se ai me djalin e xhaxhait, shtetasin E. Xh. S. – nisur nga fakti i diferencës relativisht të madhe të moshës me të dhe i distancës së vendbanimit që nga viti 2005 e në vijim, si dhe disa rrethanave familjare – nuk ka pasur asnjëherë marrëdhënie të afërta, pasi ato kanë konsistuar vetëm në takime rastësore, kryesisht në raste familjare, dhe midis tyre nuk ka ekzistuar e nuk ekziston asnjë formë komunikimi tjetër (si telefon, elektronik, aplikacione të ndryshme komunikimi, rrjete sociale etj.). Po ashtu, subjekti ka sqaruar se takimi i fundit me shtetasin e sipërpërmendur, E. S., ka ndodhur në një rast familjar në Pukë, në datën 20.2.2020, moment i cili përkon edhe me vdekjen e xhaxhait të tyre, S. S., dhe që prej asaj kohe nuk kanë pasur kontakt të asnjë forme me këtë shtetas¹¹.

60. Në përfundim të sa më sipër, duke mbajtur në konsideratë se nga hetimi i kryer nga Komisioni nuk ka rezultuar që subjekti të ketë qenë i përfshirë në veprimtari të kundërligjshme, faktin se subjekti ka vetëdeklaruar në kohë rrethanat në të cilat gjendej i afërmi i tij, si dhe shpjegimet lidhur me frekuentimet me shtetasin në fjalë, duket se përmbushen kriteret e besueshmërisë për t'u vlerësuar si rrethanë lehtësuese – në kuadër të parashikimeve të nenit 38, pika 7, shkronja “d” e ligjit nr. 84/2016 – ekzistencën e një të afërmi të dënuar për prodhimin dhe shitjen e narkotikëve. Për sa më sipër, trupi gjykues ka arritur në përfundimin se përmbushen kriteret e besueshmërisë për t'u vlerësuar si rrethanë lehtësuese në kuadër të parashikimeve të nenit 38, pika 5, shkronjat “b” dhe “c” të ligjit nr. 84/2016.
61. Në përfundim të rivlerësimit për kriterin e kontrollit të figurës, bazuar në të dhënat që disponohen, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit Jurgen Selimi arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës sipas parashikimit të nenit 59/1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, për sa kohë nga verifikimet e kryera: (i) nuk rezultoi se ai ka pasur apo të ketë aktualisht kontakte të papërshtatshme (jo rastësore) me persona të përfshirë në krimin e organizuar; (ii) ka dorëzuar në kohë deklaratën për kontrollin e figurës; (iii) nuk ka bërë deklaratime të pasakta, të paplota dhe nuk ka fshehur të dhëna apo kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

C. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

62. Këshilli i Lartë Gjyqësor ka miratuar dhe përcjellë pranë Komisionit raportin nr. *** prot., datë 31.3.2023, për vlerësimin e aftësive profesionale. Pas analizimit të këtij raporti, Komisioni, në bazë të neneve 40-44 të ligjit nr. 84/2016, ka kryer rivlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit Jurgen Selimi, në përputhje me nenin E të Aneksit të Kushtetutës.
63. Rivlerësimi i aftësive profesionale është mbështetur në: (a) raportin për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer dhe të përcjellë në Komision; (b) informacionin e marrë nga burime të ligjshme, si i tillë është konsideruar informacioni i marrë nga denoncimet dhe organet ligjzbatuese, burime, të cilat, kur ka qenë nevoja, i janë nënshtruar verifikimit të vërtetësisë së tyre nga Komisioni; (c) kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
64. Raporti i përcjellë nga KLGJ-ja është kontrolluar në drejtim të saktësisë dhe të standardizimit të tij, raport i cili ka të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të

¹¹ Subjekti ka bashkëlidhur certifikatën e vdekjes nga akti datë 6.9.2024, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile, Njësia Administrative ***.

vlerësimi: (i) aftësive profesionale; (ii) aftësive organizative; (iii) etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale; (iv) aftësive personale dhe angazhimit profesional.

65. Në të tetë dokumentet e vëzhguara nga KLGJ-ja ka rezultuar se ndihmësi ligjor Jurgen Selimi, në çdo rast, ka evidentuar saktë dhe qartë rrethanat e mosmarrëveshjes, ka vlerësuar nëse rekursi është ushtruar brenda afatit ligjor, si dhe nëse rekursi i është drejtuar palës ndërgjyqëse përkatëse. Në relacionet e përgatitura prej tij nuk mungon analiza ligjore e vendimit gjyqësor ndaj të cilit është ushtruar rekurs, si nga pikëpamja e zbatimit të ligjit procedural, ashtu edhe në drejtim të zbatimit të ligjit material lidhur me zgjidhjen në themel të çështjes.
66. Në lidhje me aftësitë organizative, etikën dhe angazhimin profesional të ndihmësit ligjor Jurgen Selimi nuk janë evidentuar problematika.

Rivlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni

67. Komisioni, në bazë të neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka analizuar raportin e KLGJ-së, si dhe dokumentacionin përkatës bashkëngjitur, ka kryer rivlerësimin e aftësive profesionale në përputhje me nenin E të Aneksit të Kushtetutës, duke shqyrtuar edhe informacionet e marra nga denoncimet nga publiku dhe organet e tjera ligjzbatuese, si dhe ka analizuar dosjet profesionale të administruara për këtë qëllim.
68. Pasi u njoh dhe analizoi dokumentacionin e depozituar nga KLGJ-ja, mbi të cilin është hartuar raporti i vlerësimit profesional për këtë subjekt rivlerësimi, Komisioni nuk ka konstatuar problematika.
69. Gjatë hetimit, në përgjigje të kërkesës së Komisionit, Prokuroria e Përgjithshme¹² bëri me dije se pas konfirmimit edhe nga prokuroritë e rretheve nuk kanë rezultuar kallëzime apo procedime penale ndaj subjektit Jurgen Selimi.
70. Pranë Komisionit për subjektin e rivlerësimit Jurgen Selimi nuk janë paraqitur denoncime nga publiku.
71. Referuar të dhënave nga Shkolla e Magjistraturës mbi rezultatet e testimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit Jurgen Selimi, nga verifikimi i tabelave të rezultateve është konstatuar se në fazën e parë të testimit të aftësive profesionale “Testi elektronik”, subjekti është vlerësuar me 58 pikë, nga 100 pikë të mundshme, ndërsa në fazën e dytë “Testi profesional” është vlerësuar me 116 pikë, nga 200 pikë të mundshme.
72. Gjithashtu, Komisioni vëren se: *“Këshilltari ligjor i Gjykatës Kushtetuese, ndihmësi ligjor i Gjykatës së Lartë, si dhe ndihmësi ligjor në Prokurorinë e Përgjithshme, të cilët nuk janë magjistratë, vlerësohen bazuar në: a) relacionet dhe mendimet ligjore të përgatitura; dhe b) rezultatet e testimit pranë Shkollës së Magjistraturës”*. Vlerësimi i ndihmësve ligjorë pranë Gjykatës së Lartë do të kryhet edhe duke u bazuar në parashikimin e nenit 21 të ligjit nr. 8588, datë 15.3.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në nenin 25 të rregullores së brendshme të Gjykatës së Lartë, miratuar me urdhrin nr. ***, datë 12.9.2014, të kryetarit të kësaj Gjykate.
73. Nga vlerësimi i kryer, bazuar në këto kritere, nuk janë konstatuar problematika lidhur me aftësitë profesionale të subjektit. Gjithashtu, sikurse është përshkruar edhe më sipër, nga vendimi nr. ***, datë 21.5.2018, i Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, ka rezultuar se ndihmësi ligjor Jurgen Selimi në fazën e parë të testimit të aftësive profesionale është vlerësuar me 58 pikë, nga 100 pikë të mundshme, ndërsa në fazën e dytë është vlerësuar me 116, nga 200 pikë që ishte maksimumi i parashikuar, dhe kështu ai është kualifikuar si i aftë për të vijuar në detyrën e ndihmësit ligjor.
74. Në konkluzion përfundimtar, bazuar në sa është përshkruar më sipër, lidhur me kriterin e aftësive profesionale, Komisioni çmon se për subjektin e rivlerësimit nuk është konstatuar

¹² Me shkresën nr. *** prot., datë 29.2.2024.

ndonjë mangësi apo problematikë etiko-profesionale dhe, për rrjedhojë, z. Jurgen Selimi ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas kritereve të kërkuara nga ligji nr. 84/2016.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Jurgen Selimi:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës, nenin D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi, në bazë të shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 58, si dhe të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Jurgen Selimi, ndihmës ligjor në Gjykatën Administrative të Apelit.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ndaj këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik dhe/ose subjekti i rivlerësimit 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në datën 10.10.2024.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Firdes SHULI
Kryesuese

Lulzim HAMITAJ
Relator

Etleda ÇIFTJA
Anëtare